



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.631/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-93239-04-15-2021 me objekt Loti 1 “*Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond të Marrëveshjes Kuadër 18,014,988 Lekë (Pa TVSH), zhvilluar në datën 10.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Shtëpia Botuese Shtypshkronja Morava” SHPK dhe “Rama Graf” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: “Inpress” SHPK
Rruga “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave tregtare
Tiranë

“Albdesign PSP” SHPK

Rruga “Cerciz Topulli”, Objekti Nr.17 kahar Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi

më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 15.04.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-93239-04-15-2021 me objekt Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond të Marrëveshjes Kuadër 18,014,988 Lekë (Pa TVSH), zhvilluar në datën 10.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 10.05.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Në datën 25.05.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Inpress	12,596,020	I skualifikuar
- SH.B SH.Morava	12,907,000	I kualifikuar
- Rama -Graf	13,621,400	I kualifikuar
- Albdesign PSP	14,134,720	I kualifikuar
- Kristalina KH	14,151,100	I kualifikuar
- Adel Co	15,318,750	I kualifikuar
- Dynamicx Group	15,500,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 25.05.2021 operatori ekonomik “Inpres” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka provuar se disponon*

minimumi dy makina shtypi me format min 50 cm x 70 cm në një nga format e percaktuara në DST.

II.5. Në datën 28.05.2021 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në pikën 3.3.2 kapaciteti teknik të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit përcaktohet se: Operatori ekonomik për të vertetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme*

- *Minimumi dy makina shtypi me format min 50cm X 70 cm;*
- *Minimumi dy makina qepëse;*
- *Minimumi dy makina telefoni;*

Operatori ekonomik për të vertetuar se i disponon keto gjashtë pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- *Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose*
- *Kontrate huapërdorje, ose*
- *Kontrate qiramarrje, ose*
- *kontrata e dhurimit;*

OE Inpres në përputhje të plotë me kërkesat e kësaj pikë ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Makinieri Shtypi Offset 5 color, 50x70, Heidelberg, 520238, pronësi, dokument provues kontratë dhurimi+raport vlerësimi +bilanc 2016,2017,2018*
- *Makinieri Shtypi Offset 2 color, 50x70, Heidelberg, 532337, pronësi, dokument provues kontratë dhurimi+raport vlerësimi +bilanc 2016,2017,2018.*
- *Makinieri shtypi Offset 2 color, 70x100, Heidelberg, 515523, pronësi, dokument provues kontratë dhurimi+raport vlerësimi +bilanc 2016,2017,2018.*

- -----

Së pari do të donim të nënvizojmë se me të njëjtat pajisje OE Inpres SHPK ka realizuar me sukses vitet e kaluara 2019,2020 me AK Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Së dyti : OE Inpres SHPK në përputhje të plotë me kriterin ka paraqitur dokumentacionin ligjor: Kontratë dhurimi+raport vlerësimi+bilanc 2016,2017,2018 për disponimin e 3 makinieri shtypi me format min 50x70 cm. Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon. Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe regjistrohet përndryshe është i pavlefshëm. Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme kontrata quhet e lidhur nga casti i dorëzimit të sendit. Përpara se kontrata të jetë lidhur dhuruesi ose pranuesi i dhurimit mund të revokojnë deklaratën e tyre.

- *Për sa i përket kontaktimit tërësisht të gabuar të KVO do të donim të nënvizojmë se:*

- *Deklarata noteriale nr.2689 rep nr.887/1 kol datë 12.12.2017 redaktuar dhe nënshkruar pranë noteres M.B pavarësisht titullit është një kontratë dhurimi e mirfilitë e sendeve/pasurive të luajtshme.*
- *Menjherë pas nënshkrimit të kontratës së dhurimit Deklaratë Noteriale të gjitha pasuritë e luajtshme (pajisjet/makineritë e shtypshkrimit) janë dorëzuar rregullisht tek pranuesi i dhurimit shoqëria Pena SHPK ish emri tregëtar i shoqërisë Inpres SHPK.*
- *Kontrata e sipërcituar e dhurimit Deklaratë Noteriale për sa i përket formës ligjore është tërësisht në përputhje me përcaktimet në kriter pasi është redaktuar nga noteri publik në përputhje me nenin 761 e vijues të KC.*
- *Për më shumë të gjitha pajisjet e dhuruara nëpërmjet Kontratës së Dhurimit janë vlerësuar nga ekspertë vlerësues të licensuar si dhe janë pasqyruar rregullisht në Pasqyrat Financiare të shoqërisë tregëtare Inpress SHPK e cila është pronar i këtyre pajisjeve.*
- *Për sa më sipër kërkohet shpalljen fitues të OE Inpress SHPK..*

II.6. Me shkresën nr. 972/2prot datë03.06.2021 operatori ekonomik "Inpress" SHPK ka marrë dijeni lidhur me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 07.06.2021pala ankimuese "Inpress" SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 31.05.2021operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPKka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Shoqëritë Shtëpia Botuese Morava SHPK dhe Rama Graf SHPK janë kualifikuar në kundërshtim me LPP.*
- *Së pari në lidhje me kualifikimin e Shtëpia Botuese Morava SHPK bazuar në dyshime të arsyeshme ndodhet në kushtet në të cilat përmbush dy kushte kumulative të parashikuara në ligj për auditimin e pasqyrave financiare. Vlerësojmë se ky operator në dokumentacionin e dorëzuar nuk i ka shoqëruar kopjet e certifikuar të bilanceve me akt -ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar duke mos përmbushur këtë kriter. Gjithashtu nga kërkimet e kryera na rezulton që këto raporte auditimi nga eksperti kontabël nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik Shtëpia Botuese Morava SHPK as në QKB në momentin e hapjes së ofertave në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.*
- *Bazuar në dyshime të arsyeshme na rezulton se operatori Shtëpia Botuese Morava SHPK apo dhe operatori me të cilin ky operator ekonomik mund të ketë marrë pjesë në procedurë në datën e zhvillimit të procedurës nuk kanë shlyer detyrimet e energjisë elektrike për të gjitha kontratat e energjisë që ka ky operator ekonomik duke përfshirë muajin Mars 2021 .*
- *Bazuar në dyshime të arsyeshme vlerësojmë se operatori ekonomik Shtëpia Botuese Morava SHPK nuk disponon në një nga format e parashikuara në DT të 6 pajisjet e*

kërkuara nga AK për realizimin me sukses të kontratës dhe për këtë arsye kërkojmë verifikimin e disponimit të këtyre pajisjeve nga ky OE.

- Bazuar në dyshime të arsyeshme vlerësojmë se operatori ekonomik Shtëpia Botuese Morava SHPK apo dhe operatori me të cilin ky OE mund të ketë marrë pjesë në këtë procedurë nuk disponojnë furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të këtij loti. Edhe nëse këta operatorë disponojnë furnizime në një vlerë 40% të fondit limit kërkojmë të bëhen verifikime pasi kontratat duhet të jenë të ngjashme me shërbimet e kërkuara. Shtëpia Botuese Morava SHPK apo dhe operatori me të cilin ky OE mund të ketë marrë pjesë në këtë procedurë nuk disponojnë furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit të këtij loti për shërbimin e botimeve dhe printimeve të artikujve të parashikuara për përdorim spitalor të ngjashme me ato të parashikuara në shtojcën 11 shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit si psh blloqe për përdorim, kartela për përdorim, regjistra për përdorim etj.
- Gjithashtu kemi dyshime se Shtëpia Botuese Morava SHPK nuk ka plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara shtojcën 7 Deklartatë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme pasi nuk ka specifikuar të gjithë listën e personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit, aksionerit, ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese vendimarrëse ose kontrolluese brenda OE me të dhënat e secilit prej tyre.
- Së dyti Rama Graf SHPK
- Bazuar në dyshime të arsyeshme ndodhet në kushtet në të cilat përmbush dy kushte kumulative të parashikuara në ligj për auditimin e pasqyrave financiare. Vlerësojmë se ky operator në dokumentacionin e dorëzuar nuk i ka shoqëruar kopjet e certifikuara të bilanceve me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar duke mos përmbushur këtë kriter. Gjithashtu nga kërkimet e kryera na rezulton që këto raporte auditimi nga eksperti kontabël nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik Rama Graf SHPK as në QKB në momentin e hapjes së ofertave në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Bazuar në dyshime të arsyeshme na rezulton se operatori Rama Graf SHPK apo dhe operatori me të cilin ky operator ekonomik mund të ketë marrë pjesë në procedurë në datën e zhvillimit të procedurës nuk kanë shlyer detyrimet e energjisë elektrike për të gjitha kontratat e energjisë që ka ky operator ekonomik duke përfshirë muajin Mars 2021 .
- Bazuar në dyshime të arsyeshme vlerësojmë se operatori ekonomik Rama Graf SHPK nuk disponon në një nga format e parashikuara në DT të 6 pajisjet e kërkuara nga AK për realizimin me sukses të kontratës dhe për këtë arsye kërkojmë verifikimin e disponimit të këtyre pajisjeve nga ky OE.
- Bazuar në dyshime të arsyeshme vlerësojmë se operatori ekonomik Rama Graf SHPK apo dhe operatori me të cilin ky OE mund të ketë marrë pjesë në këtë procedurë nuk

disponojnë furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të këtij loti. Edhe nëse këta operatorë disponojnë furnizime në një vlerë 40% të fondit limit kërkojmë të bëhen verifikime pasi kontratat duhet të jenë të ngjashme me shërbimet e kërkuara. Rama Graf SHPK apo dhe operatori me të cilin ky OE mund të ketë marrë pjesë në këtë procedurë nuk disponojnë furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit të këtij loti për shërbimin e botimeve dhe printimeve të artikujve të parashikuara për përdorim spitalor të ngjashme me ato të parashikuara në shtojcën 11 shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit si psh blloqe për përdorim, kartela për përdorim, regjistra për përdorim etj.

- *Gjithashtu kemi dyshime se Rama Graf nuk ka plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara shtojcën 7 Deklartaë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme pasi nuk ka specifikuar të gjithë listën e personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit, aksionerit, ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese vendimarrëse ose kontrolluese brenda OE me të dhënat e secilit prej tyre.*

II.9. Në datën 03.06.2021 me shkresën nr.989/2 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.10. Në datën 11.06.2021 pala ankimuese “Albdesign PSP” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt-ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.1066/1 prot datë 21.06.2021 protokolluar me tonën me nr.989/2 prot datë 25.06.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka provuar se disponon minimumi **dy makina shtypi me format min 50**

cm x 70 cm në një nga format e percaktuara në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3/2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik për të vertetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme*

- *Minimumi dy makina shtypi me format min 50cm X 70 cm;*
- *Minimumi dy makina qepëse;*
- *Minimumi dy makina telefoni;*

Operatori ekonomik për të vertetuar se i disponon keto gjashtë pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- *Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose*
- *Kontrate huapërdorje, ose*
- *Kontrate qiramarrje, ose*
- *kontrata e dhurimit;*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Inpress”SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë Noteriale Nr.2689 Rep, Nr.887 Kol datë 12.12.2017 me përmbajtje ndër të tjera si vijon:

SH.N dhe shoqëria Pena SHPK

Unë SH.N deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se kam në pronësinë time të gjitha pajisjet si më poshtë vijon:

.....

.....

Makineri offset 5 ngjyrësh 50x70 1 copë marka Heidelberg me nr.serie 520238

Makineri offset 2 ngjyrësh 50x70 1 copë marka Heidelberg me nr.serie 532337

Gjithashtu unë SH.N deklaroj me dëshirën dhe vullnetin tim të lirë dhe të plotë se të gjitha pajisjet e mësipërme ja dhuroj pa kundërshpërblim shoqërisë Pena SHPK.

Gjithashtu unë E.D në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë Pena SHPK deklaroj se i kam marrë në dorëzim dhe pranoj dhurimin pa kundërshpërblim të të gjitha pajisjeve të mësipërme nga SH.N.

- Raport Vlerësimi nga Lura Studio
- Konfirmim Pasqyra Financiare

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.
b) aftësiat e teknike: operatorë ekonomikë vërtetë jo nëse zotërojnë kualifikime të nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e aseteve të tjerë fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Neni 761 “Dhurimi” i ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon. Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi.

Neni 764 i ligjit të sipërcituar parashikon se:

“Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm. Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm.

Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimit i është njoftuar dhuruesit.

Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit.

Kontrata quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit.

Përpara se kontrata të jetë lidhur, dhuruesi ose pranuesi i dhurimit mund të revokojnë deklaratën e tyre.

Neni 162 “Kalimi i pronësisë”

E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.

Neni 163 “Mënyrat e fitimit të pronësisë”

Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë.

III.1.6.Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara e në mënyrë të veçantë nenit 163 të Kodit Civil “Mënyrat e fitimit të pronësisë”, thuhet se “pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Referuar dokumentacionit të administruar për çështjen objekt-gjykimi, rezulton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar “Deklaratë Noteriale” pasqyruar si më sipër. Së pari, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të saktësojë pozitën e tij, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimit, brenda kompetencave të dhëna nga ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në respekt të kërkesave të autoritetit kontraktor, KPP konstaton, se ky i fundit ka parashikuar ndër të tjera se: *Operatori ekonomik për te vertetuar se i disponon keto gjashtë pajisje duhet te paraqese dokumentacionin ne nje nga format e meposhtme: **Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose Kontrate huaperdorje, ose Kontrate qiramarrje, ose kontrata e dhurimit.*** Referuar kriterit të përcaktuar nga autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues pretendon, se ka dëshmuar disponueshmërinë e mjeteve me anë të Deklaratës noteriale, e cila referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit ka fuqinë dhe vlefshmërinë e një kontrate dhurimi me të gjitha elementet e saj. Në lidhje me këtë pretenim të ankimuesit, KPP gjykon, se deklarata e kryer nga noteri është konform kompetencave që i jep ligji, por nuk është një kontratë dhurimi sipas dispozitave respektive të Kodit Civil.KPP gjykon se së pari, kemi të bëjmë me dy natyra të ndryshme aktesh juridike, deklaratë noteriale dhe kontratë dhurimi, e cila kjo e fundit rregullohet në mënyrë të posaçme në nenet 761 e vijues të Kodit të Civil. Kështu, ligjvënësi, me aktin më të lartë, Kodi Civil ka rregulluar edhe elementet konkrete që duhet të përmbajë një kontratë dhurimi, duke përfshirë garancitë esenciale,sikundër është specifikimi i sendeve të luajtshme duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit si dhe kushtin që kontrata quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit. KPP gjykon, se në tërësi në mënyrat e fitimit të pronësisë parashikuar nga Kodi Civil, në asnjë rast nuk parashikohet fitimi i pronësisë me anë të deklaratës noteriale. Kështu, *inter allia dhe mutatis mutandis* në interpretim të dispozitave të Kodit Civil, Kolegji Civil i Gjykatës Lartë në Vendimin Nr.00-2012-2804 i Vendimit (438), vitit 2012 ndër të tjera ka intepretuar se : **“Deklarata noteriale është një shprehje e njëanshme vullneti, deklaratë nga e cila deklaruesi mund të tërhiqet në çdo kohë e rrethanë.”** KPP vëren se mënyrat e fitimit të pronësisë të parashikuara nga Kodi Civil janë ato me anë të kontratës, me trashëgim, me dhurim, por në asnjë dispozitë nuk rezulton të jetë parashikuar si mënyrë fitimi pronësie deklarata noteriale.

Gjithashtu edhe në ligjin për noterinë të aplikueshëm në kohën e lëshimit të deklaratës, KPP vëren se nuk ka një rregullim specifik lidhur me këtë fakt duke mos u njohur deklaratata në asnjë rast si një mënyrë e fitimit të pronësisë. Deklarata e paraqitur në rastin konkret me objekt dhurimin e makinerive të sipërcituara, është një shfaqje e ligjshme e vullnetit të palëve ku deklarohet se makinieritë i dhurohen shoqërisë Inpress SHPK, por deklarata në vetvete nuk mund të konsiderohet si akt për kalim pronësie, pasi dispozitat ligjore në fuqi parashikojnë shprehimisht se kalimi i pronësisë në cdo rast duhet të bëhet në formën e parashikuar në ligji, në rastin konkret me anë të **kontratës së dhurimit**. Në këtë kuptim KPP gjykon, se forma e zgjedhur nga ana e operatorit ekonomik Inpress SHPK për të përmbushur kriterin e kualifikimit lidhur me disponimin e makinierive, nuk është ajo e parashikuar në ligj dhe nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës objekt-ankimi.

III.1.7. Akoma më tej, Komisioni vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht dhe në mënyrë shteruese format /mënyrat e disponimit të pajisjeve e konkretisht me anë të kontratë shitblerje/ faturë shitblerje, ose kontratë huapërdorje, ose kontratë qiramarrje, ose kontrata e dhurimit. Në kushtet kur kërkesa e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit është shprehur qartësisht, se mënyrat e disponimit do të jenë ato të cituara më lart, do të thotë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë qenë të ndërgjegjshëm se disponimi i saj me anë të mjeteve të tjera juridike të ndryshme nga ato të kërkuara, do të përbënte rrezik potencial për skualifikim. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur një kontratë shitblerje/faturë shitblerje, ose kontrate huapërdorje, ose kontrate qiramarrje, ose kontratë dhurimi, por një deklaratë noteriale duke mos përmbushur kështu kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor, që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinieritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Inpres" SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Albdesign PSP" SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë Shtëpia Botuese Morava SHPK dhe Rama Graf SHPK, KPP gjykon, se në ankesën drejtuar pranë KPP, operatori ekonomik

ankimues “Albdesign PSP” SHPK nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar.

III. 2.1. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3: Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.2.2. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tyre, ankimesit duhet të kishin shoqëruar ankesën e tyre me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjëvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin, që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik, që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik, ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron

mbi pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

III.2.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.7. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cila thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për rrjedhojë pretendimet e ankimesit “Albdesign PSP” SHPK nuk merren shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF-93239-04-15-2021 me objekt Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond të Marrëveshjes Kuadër 18,014,988 Lekë (Pa TVSH), zhvilluar në datën 10.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 989 Protokoli, Datë 07.06.2021

Nr.1043 Protokoli; Datë 11.06.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri